



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafit 7 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe neni 40 paragrafi ??? nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), duke vepruar pas denoncimit nga parashtrues i njohur, në seancës së 46-të të mbajtur me datë 12 shkurt 2021, KSHPK morri

VENDIM

Akuzat nga denoncimi për ekzistimin e konfliktit të interesave në procedurën e punësimit të personit të afërt (bashkëshortes) të personit zyrtar, drejtor i SHMK, të realizuar nga ana e tij **JANË TË BAZUARA.**

Përshkak të veprimit të Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit me ngritjen e procedurës për kundërvajtje dhe veprimit të organit kompetent pas dorëzimit të Iniciativës për ngritje të procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë të personit zyrtar, procedura **NDËRPRITET.**

Në përputhje me Ligjin për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm.

Procedura për lëndën me numër 09-5303/1 me datë 20.11.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

SQARIM

Lënda me numër 09-5303/1 me datë 20.11.2019 është formuar në bazë të denoncimit marrë nga Partia politike, kundër personit, drejtor në SHMK, me dyshime se i njëjti e ka punësuar bashkëshorten e vet si mësimdhënëse për lëndën Arsim qytetar në shkollën e njëjtë ku personi zyrtar e kryen funksionin e drejtorit.

Për vërtetim të akuzave nga denoncimi, KSHPK u drejtua deri tek SHMK me Kërkesë për dorëzim të të dhënave dhe informacioneve nr. 09-5303/2 me datë 26.11.2019 dhe pas marrjes së dokumentave të kërkuara KSHPK e caktoi gjendjen faktike vijuese:

Vendi i punës, mësimdhënës për lëndën Arsim qytetar, është i paraparë me Aktin për sistematizim të vendeve të punës në SHMK Për plotësimin e këtij vendi të punës në shtator të viti 2019 nuk është shpallur konkurs publik për punësim, mirëpo vendi i njëjtë është plotësuar nëpërmjet Kërkesës së dorëzuar për ndërmjetësim nga ana e SHMK deri tek Agjensioni për punësime, njësia rajonale, nëpërmjet Listës për ndërmjetësim të kandidatëve për punësim për punë urgjente dhe çështje që nuk shtyhen – mësimdhënës për Arsim qytetar.

Lista për ndërmjetësim të kandidatëve për punësime për punë urgjente dhe çështje që nuk shtyhen nuk është dorëzuar në shtojcën e dokumentacioneve dorëzuar deri tek KSHPK, mirëpo parafrzohet në përgjigjen e dorëzuar nga SHMK deri tek KSHPK se personi ka qenë kandidat i vetëm në listë për këtë vend të punës.

Deri tek agjensioni për punësime, njësia rajonale me datë 18.09.2019 është dorëzuar informim nënshkruar nga vetë drejtori në të cilën theksohet se nga Lista për ndërmjetësime për vendin e punës mësimdhënës për Arsim qytetar, pas intervjusë së bërë për

punën nga ana e personit përgjegjës në SHMK është zgjedhur kandidati i cili e ka pranuar punën. Gjegjesisht, deri tek KSHPK nuk është dorëzuar procesverbal nga intervjuja e bërë, kurse nga dokumentacioni i dorëzuar mund të konstatohet se është bërë nga vet drejtori si person i autorizuar në këtë shkollë, gjë që vërehet nga Autorizimi i dhënë për realizimin regjistrim/çregjistikim në APRM nga ana e drejtorit të shkollës.

Kontratën për punë në kohë të caktuar për punë urgjente dhe çështje që nuk shtyhen me orar jo të plotë prej 12 orë javore, vulosur me nr.04-568/1 me datë 18.09.2019 deri në tre muaj e ka nënshkruar drejtori i SHMK, dhe personi, persona të afërt në përputhje me nenin 8 paragrafi 4 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Gjatë kësaj gjendje faktike, Komisioni shtetëror vërtetoi se personi, drejtori i SHMK, ka vepruar në kundërshtim me nenin 74 paragrafi 1 dhe neni 75 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, dhe nuk ka vepruar në përputhje me nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 nga i njëjti ligj.

Gjegjesisht, personi zyrtar, në kundërshtim me dispozitat e theksuara nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, ka marrë pjesë dhe ka vendosur në procedurën për zgjedhje të kandidatit për vend të punës në institucionin ku kryen autorizime publike dhe angazhime, gjegjesisht, ka shfrytëzuar funksionin që të bën veprime të cilët sipas ligjit nuk duhet, gjatë së cilës ka vepruar nga lidhje familjare dhe ka bërë konflikt të interesave.

Komisioni shtetëror gjithashtu konstaton se personi zyrtar ka qenë i vetëdijshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesave, mirëpo nuk ka kërkuar të përjashtohet dhe të ndërpret me veprimin e tij. Duke vepruar në këtë mënyrë, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, personi i lartpërmendur i ka shkelur parimet e ligjit dhe integritetin gjatë kryerjes së autorizimeve të veta publike në përputhje me nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 44 nga LPKKI.

Në bazë të nenin 114 paragrafi 3 nga LPKKI, KSHPK i shqipton fleturdhëres për kundërvajtje me nr.09-3179/4 me datë 11.09.2020 personit zyrtar drejtor i SHMK i cili ka shkelur nenin 74 paragrafi 1 dhe neni 75 paragrafi 1, dhe dënuar sipas nenin 107 paragrafi 1 alinea 1 dhe 2 nga LPKKI. Gjithashtu, KSHPK i ka lëshuar edhe një fletëurdhëresë për kundërvajtje me nr.09-3179/2 me datë 11.09.2020 personit të njëjtë i cili ka shkelur nenin 56 paragrafi 2, kurse është dënuar sipas nenin 105 paragrafi 1 alinea 14 nga LPKKI përshkak se në afatin e paraparë me ligj pas punësimit të anëtari të familjes së tij (bashkëshortes) në organin e vetëqeverisjes lokale nuk e ka informuar KSHPK:

Personi zyrtar, drejtor i SHMK ka bërë pagesën e të dy fleturdhëresave për kundërvajtje brenda afatit të caktuar me ligj gjegjesisht ka paguar gjysmën e gjobës së shqiptuar në përputhje me LPKKI.

Përshkak të gjendjes faktike të caktuar dhe shkeljeve të caktuar sipas dispozitave të LPKKI, Komisioni shtetëror deri tek Kryetari i komunë së, ka dorëzuar Iniciativë për ngritje të procedurës për caktim të përgjegjesisë të personit zyrtar drejtor i SHMK me nr.09-3179/5 me datë 16.09.2020.

Kryetari i komunës së dorëzoi përgjigje deri tek KSHPK me nr.09-3179/8 me datë 12.11.2020 në lidhje me atë se me datë 21.09.2020 morri vendim për fillim të

procedurës për caktim të përgjegjësive të personit zyrtar drejtori i SHMK

Në përputhje me nenin 93 paragrafi 1 alinea 2 dhe neni 105 nga Ligji për arsim të mesëm, kryetari i komunës deri tek Ministria e arsimit dhe Inspektorati shtetëror i arsimit dërgoi kërkesë për realizim urgjent të ligjshmërisë së punës së drejtorit.

Inspektorati shtetëror i arsimit me datë 29.09.2020 bëri inspektim të jahtëzakonshëm në SHMK nga dhe përpiloi procesverbal në të cilën konstaton se organet udhëheqëse të kësaj shkolle nuk i kanë thyer dispozitat e Ligjit për arsim të mesëm dhe Ligjin për mësimdhënës dhe bashkëpunor profesional për shkolla të mesme dhe fillore.

Përskaaj veprimeve të përmendura, gjithashtu, kryetari i komunës në përputhje me nenin 89-a dhe 93-b nga Ligji për arsim të mesëm u drejtua edhe deri tek Këshilli i shkollës së shkollës së njëjtë dhe të vepron për Iniciativën e dorëzuar nga ana e KSHPK.

Këshilli i shkollës së SHMK nga me datë 09.11.2020 mbajti mbledhje në të cilën morri vendim se nuk ka bazë për ngritje të procedurës për përgjegjësi, gjegjësisht shkarkim të drejtorit dhe se nuk do të dorëzon deri tek kryetar i komunës propozim për shkarkim të të njëjtit, me çka me datë 10.11.2020 është lajmëruar kryetari i komunës

Pas përgjigjeve të marra nga organet kompetente, kryetari i komunës konstaton se e ka kryer obligimin e vet pas Iniciativës së dorëzuar nga ana e KSHPK në procedurën e filluar dhe me datë 10.11.2020 morri vendim për ndërprerje të procedurës për vërtetim të përgjegjësive të personit zyrtar drejtor në SHMK

Në përputhje me të shënuarën më sipër, akuzat e vërtetuara nga denoncimi, si dhe veprimet e ndërmarra nga ana e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, gjegjësisht Iniciativa e marrë për ngritje të procedurës për vërtetim të përgjegjësive të personit zyrtar drejtor në SHMK dhe veprimi për të njëjtën nga organ kompetent, KSHPK në seancën e 46-të konstatoi se është arritur efekti nga veprimet e tij përshkak të së cilës vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Pas përfundimit të KSHPK
Përpunoi: K. Z., këshilltarë
Miratoi: N. B., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska**